



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

**th ë r r e t**

mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **18.04.2019** dhe do të filloj në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM1);
3. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuem dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit;

9. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
10. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezident të Prishtinës;
11. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-060/01-83175/19, më 10.04.2019

KRYESUESI I KOMITETIT

Agim Kuleta

